

Shoqëria "ELECTREUS" Sh.p.k.
Regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS L82322032S

VENDIM
i Ortakut të vetëm të shoqërisë
"ELECTREUS" Sh.p.k.

Ky vendim u mor sot më datë 06/10/2022, në selinë e shoqërisë "ELECTREUS" Sh.p.k. Në këtë mbledhje merr pjesë Ortakja e Vetme e Shoqërisë:

1. Zj. Dorotea Bregu, Ortake e vetme dhe Administratore i shoqërisë

Rendi i ditës:

- Zmadhimi i kapitalit të shoqërisë;
- Caktimin e Audituesit ligjor (EKR) për hartimin e Raportit të Zmadhimit të Kapitalit të Shoqërisë;
- Të tjera eventuale.

Në bazë të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe shoqëritë tregtare", dhe në bazë të Statutit të Shoqërisë, ortaku i vetëm i shoqërisë

VENDOSI:

1. Zmadhimin e kapitalit të shoqërisë në vlerën 7,000,000 lekë.
2. Vlera prej 7,000,000 lekë, e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, përbëhet nga 2,663,619 lek fitimi i vitit 2021 dhe 4,336,381 Lek fitimi i pashpërndarë.
3. Caktimin e Z. Rezar Llukaçej, Auditues ligjor (EKR) pranë shoqërisë Kreston Albania Sh.p.k, me NUIS L42007012I, për hartimin e Raportit të Zmadhimit të Kapitalit të Shoqërisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Lexuar, aprovuar e nënshkruar nga Ortakja e vetme e shoqërisë.

SHOQËRIA "ELECTREUS" SH.P.K.
ORTAKU I VETËM
DOROTEA BREGU

